


INDEKSI I ÇMIMEVE TË KONSUMIT

Korrik 2026

Norma e inflacionit e matur me Indeksin e Çmimeve të Konsumit (IÇK) në muajin Korrik 2026 ishte 3,4 për qind, nga 2,5 për qind në Korrik 2025.

Krahasuar me muajin Qershor 2026, çmimet e konsumit u rritën me 0,2 për qind.


FIG. 1 NDRYSHIMET VJETORE TË INDEKSIT TË ÇMIMEVE TË KONSUMIT (%)



Ndikimi i grupeve kryesore në ndryshimin vjetor

Rritja vjetore e çmimeve në muajin Korrik është ndikuar kryesisht nga grupi "Ushqime dhe pije joalkoolike" me +1,18 pikë përqindje, pasuar nga grupi "Qira, ujë, energji elektrike, gaz dhe karburante të tjera" me +0,83 pikë përqindje. Gjithashtu, çmimet e grupit "Transporti" ndikuan me +0,52 pikë përqindje, çmimet e grupit "Mobilje, pajisje shtëpie dhe mirëmbajtje e shtëpisë" me 0,23 pikë përqindje, çmimet e grupeve "Pije alkoolike dhe duhan" dhe "Restorante dhe shërbime akomodimi" me + 0,15 pikë përqindje secili, çmimet e grupit "Kujdesi personal dhe mallra e shërbime të ndryshme" me +0,14 pikë përqindje, çmimet e grupit "Argëtim, sport dhe kulturë" me +0,12 pikë përqindje, çmimet e grupeve "Shërbimi arsimor" dhe "Sigurime dhe shërbime financiare" me +0,07 pikë përqindje secili dhe çmimet e grupit "Shëndeti" me +0,06 pikë përqindje. Nga ana tjetër çmimet e grupit "Veshje dhe këpucë" ndikuan me -0,07 pikë përqindje dhe çmimet e grupit "Informacioni dhe komunikimi" me -0,03 pikë përqindje.

FIG. 2 NDIKIMI I GRUPEVE NË NDRYSHIMIN VJETOR



Ndryshimet vjetore të grupeve kryesore: Krahasuar me muajin Korrik 2025 rritja më e madhe e çmimeve vërehet në grupin "Transporti" me 8,0 %, pasuar nga "Argëtim, sport dhe kulturë" me 6,0 %, "Sigurime dhe shërbime financiare" me 4,5 %, "Qira, ujë, energji elektrike, gaz dhe karburante të tjera" me 4,1 %, "Ushqime dhe pije joalkoolike" me 3,5 %, "Mobilje, pajisje shtëpie dhe mirëmbajtje e shtëpisë" me 3,3 %, "Kujdes personal dhe mallra e shërbime të ndryshme" me 3,1 %, etj. Nga ana tjetër, çmimet e grupit "Veshje dhe këpucë" u ulën me 1,8 %, pasuar nga grupi "Informacioni dhe komunikimi" me 0,9 %.

Ndryshimet mujore të grupeve kryesore: Krahasuar me Qershor 2026, rritja më e madhe e çmimeve vërehet në grupin "Transporti" me 4,7 %, pasuar nga grupet "Qira, ujë, energji elektrike, gaz dhe karburante të tjera" me 0,6 %, "Argëtim, sport dhe kulturë" me 0,4 %, "Mobilje, pajisje shtëpie dhe mirëmbajtje e shtëpisë" me 0,3 %, etj. Nga ana tjetër, çmimet e grupit "Informacioni dhe komunikimi" u ulën me 1,5 %, pasuar nga grupet "Veshje dhe këpucë" me 1,3 %, "Sigurime dhe shërbime financiare" me 0,6 %, "Ushqime dhe pije joalkoolike" me 0,5 % dhe "Pije alkoolike dhe duhan" me 0,3 %.

TAB. 1 INDEKSIT TË ÇMIMEVE TË KONSUMIT

Kodi	Grupet	Peshat	07-26/Viti 2025	07-26/06-26	07-26/07-25
	Gjithsej	100,0	102,9	0,2	3,4
01.	Ushqime dhe pije joalkolike	34,1	102,0	-0,5	3,5
02.	Pije alkolike dhe duhan	5,0	103,0	-0,3	3,0
03.	Veshje dhe këpucë	3,8	97,2	-1,3	-1,8
04.	Qira, ujë, energji elektrike, gaz dhe karburante të tjera	20,2	104,5	0,6	4,1
05.	Mobilje, pajisje shtëpie dhe mirëmbajtje e shtëpisë	7,0	102,9	0,3	3,3
06.	Shëndeti	3,2	101,7	0,0	1,9
07.	Transporti	6,4	108,4	4,7	8,0
08.	Informacioni dhe komunikimi	3,6	99,1	-1,5	-0,9
09.	Argëtim, sport dhe kulturë	2,0	107,1	0,4	6,0
10.	Shërbimi arsimor	3,0	101,6	0,0	2,3
11.	Restorante dhe shërbime akomodimi	5,7	102,8	0,1	2,7
12.	Sigurime dhe shërbime financiare	1,5	104,4	-0,6	4,5
13.	Kujdes personal dhe mallra e shërbime të ndryshme	4,5	102,9	0,1	3,1

Shënim për përdoruesit:

- Të dhënat e detajuara mujore dhe vjetore sipas grupeve janë të disponueshme në databazën statistikore të INSTAT: [Indeksi i Çmimeve të Konsumit](#)
- Në zbatim të Politikës së Trajtimit të Gabimeve, INSTAT ndërmerr pa vonesë korrigjimin e çdo gabimi të identifikuar në statistikatat zyrtare të publikuara. Përdoruesit informohen në mënyrë të menjëhershme dhe transparente për korrigjimet dhe ndryshimet e reflektuara, në përputhje me parimet e paanshmërisë, transparencës dhe cilësisë së statistikave zyrtare. Politika e plotë e Trajtimit të Gabimeve është e disponueshme në adresën: <https://www.instat.gov.al/media/9577/politika-e-trajtitimit-te-gabimeve.pdf>

Metodologjia

Me publikimin e të dhënave për muajin Korrik 2026, vihet në dispozicion seria kohore për periudhën 2016–2025 e Indeksit të Çmimeve të Konsumit, sipas ECOICOP 2018 (ECOICOP ver. 2). Gjatë përgatitjes së serisë kohore, disa produkte janë riklasifikuar në nivelet e detajuara. Indeksi i përgjithshëm i IÇK-së për çdo muaj mbetet i njëjtë deri në shifrën e dytë dhjetore. Për rrjedhojë, normat historike të inflacionit të përgjithshëm mbeten të pandryshuara.

Ndryshime metodologjike

Duke filluar nga Shkurt 2026, Indeksi i Çmimeve të Konsumit përlogaritet sipas klasifikimit ECOICOP 2018. Kalimi në klasifikimin e ri përfshin ristrukturimin e artikujve të shportës, riklasifikimin e disa produkteve. Struktura e ECOICOP ver. 2 përbëhet nga 13 divizione kryesore, të detajuara më tej në grupe, klasa dhe nënklasa. Implementimi i këtij klasifikimi është në përputhje me Rregulloren (BE) 2024/3159, duke siguruar harmonizimin e plotë me praktikat statistikore evropiane dhe ndërkombëtare.

Periudha e referencës së indeksit është ndryshuar nga Dhjetor 2020 = 100 në 2025 = 100.

Gjithashtu, në muajin Janar si çdo viti Indeksi i Çmimeve të Konsumit shoqërohet me disa ndryshime metodologjike sipas metodologjisë ndërkombëtare të llogaritjes së këtij treguesi, të cilat konsistojnë në:

- Përditësimin e peshave: Peshat e mallrave dhe shërbimeve janë ndryshuar duke u bazuar në shpenzimet mesatare të Anketës së Buxhetit të Familjeve 2024.
- Përditësimin e listës së mallrave dhe shërbimeve: Shporta përbëhet nga **411** produkte dhe shërbime.
- Përditësimin e listës së njësive tregtare ku mblidhen çmimet.

Indekset e Çmimeve të Konsumit janë në proces rishikimi metodologjik për shkak të zbatimit të Klasifikimit ECOICOP ver. 2.

Përkufizime

Indeksi i Çmimeve të Konsumit (IÇK) është matësi zyrtar i inflacionit në Shqipëri, Indeksi mat ndryshimet relative të çmimeve të mallrave dhe shërbimeve të përdorura nga familjet për konsum vetjak dhe llogaritet duke përdorur strukturën e konsumit final të familjeve shqiptare. Burimi kryesor i informacionit për shpenzimet është Anketa e Buxhetit të Familjeve.

Ndryshimi vjetor mat ndryshimin e indeksit të çmimeve midis muajit korrent me të njëjtin muaj të vitit të mëparshëm. Ky ndryshim është rrjedhojë e ndryshimeve korente në nivelin e çmimeve, por mund të ndikohet edhe nga efektet e papërsëritshme të cilitdo muaj.

Ndryshimi mujor mat ndryshimin e indeksit të çmimeve të muajit korrent me muajin e mëparshëm, Ky tregues është i ndjeshëm nga efektet sezonale.

Ndryshimi mesatar 12 mujor mat ndryshimin e indeksit mesatar të konsumit në 12 muajt e fundit me indeksin mesatar të 12 muajve të mëparshëm.